



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 43/2011
Prishtinë, më 15. 12. 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha - Shala, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Berat Buzhala, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Ramiz Kelmendi,

Pjesëmarrës i ftuar: Besim Beqaj Ministër i zhvillimit ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Tmava dhe Ibush Jonuzi – KPMM; Frymëzim Isufaj, Arbnor Kastrati dhe Kemjet Zeqiri - MZHE; Shkumbin Beqiri – KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe konsulentja e Komisionit - Brikena Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 09.12.2011;
3. Shqyrtimi i Strategjisë Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 09.12.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 09.12.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Strategjisë Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025;

Kryetari – Tha se tani pasi që kemi realizuar dëgjimin publik tanime kemi ftuar që të raportoi edhe ministrin e ministrisë për zhvillim ekonomik që ka hartuar Strategjinë minerare dhe që është kompetente për implementimin e saj. Dhe i'a kaloi fjalën ministrit Beqaj për raportim.

Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik – MZHE – paraqiti Raportin në vija të përgjithshme së s'i është hartuar Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025. Ai tha se është një dokument i cili bazohet në Ligjin për miniera dhe minerale. Dokument, për të cilin kemi diskutuar edhe më herët në këtë përbërje, ku kemi thënë që është kthyer. Ne kemi marrë për obligim me e rishikuar dhe me e sjellë këtë dokument, i cili do të mundëson një orientim afatgjatë kohorë për zhvillimin e sektorit minerar në Republikën e Kosovës. Ne besojmë që sektori minerar është sektor jashtëzakonisht i rëndësishëm, i cili duhet të vlerësohet dhe të evoluohet edhe konform zhvillimeve të fundit. Ky si dokument i tillë është pjesë edhe e politikave qeveritare, që janë për të vënë theksin sa më shumë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Zhvillim, i cili do të përdorë resurset natyrore të vendit dhe, realisht një strategji, e cila do të na hapë rrugë edhe për krijimin e një standardi tjetër sa i përket rentave minerare dhe formave për eksploatim të minierave të reja anekënd Kosovës. Është dokument, në hartimin e të cilit kanë marrë pjesë njerëz të profesionit, institucionet që janë përgjegjëse për miniera siç është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ekspertë të “Trepçës”. Pjesa e parë e dokumentit e bënë vlerësimin e gjendjes të cilën e kemi, pastaj është dhënë me atë, le të themi, orientimin e përgjithshëm me një mision dhe vizion dhe çështje tjera që lidhen, që janë dokumente le të themi, pjesë standarde të një dokumenti strategjik, por që vazhdon edhe me hapat të cilat duhet të merren në të ardhmen. Është thënë që, sepse e kam vërejtur edhe nga debati që është diskutuar më herët, është vënë në theks edhe në involvimin e sektorit privat, por ne besojmë që partneritetet publiko-private do të jenë me interes, por gjithmonë duke i respektuar kriteret maksimale, kërkesat ligjore për një konkurrencë të mirëfilltë, e cila i mundëson që këto resurse të materializohen gjithmonë për zhvillim ekonomik të vendit.

Hashim Deshishku - Ne kemi një material për strategjinë e minierave dhe mineraleve ku ndoshta është e gabuar, që ka mbete 2010 – 2025, apo vetëm kopjet kanë mbetur kështu. Tash nuk po di a është 2012 apo 2010. Nëse ka ndonjë ndryshim, atëherë ju kisha lutur të na tregoni.

Sala Berisha – Shala - është hera e tretë këtë vit që e kemi në dorë ose në rend të ditës strategjinë minerale të Republikës së Kosovës, për periudhën 2012 – 2015. Hera e parë, domethënë, ka qenë një rend dite, ku kemi vendos për me e mbajt një dëgjim publik dhe dëgjimi publik, mendoj që ka qenë shumë i domosdoshëm, prej të cilit kemi marrë edhe sugjerime dhe vërejtje, në kuptimin më pozitiv për plotësimin e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm. Sigurisht që në këtë dokument do të hasim edhe në data, siç e përmendi edhe kolegu Deshishku, që janë më tepër gabime teknike, të cilat janë përvjedhur prej dokumentit të mëhershëm. Në mandatin e kaluar ky dokument i ka kaluar të gjitha fazat dhe procedurat e nevojshme. Mirëpo, është kthyer. Pa asnjë arsye i është kthyer ministrisë. Ndoshta edhe kjo ka qenë vonesa edhe në këtë mandat, pse nuk ka pas ministria në fjalë ndonjë sqarim të qartë, pse, çka duhet të plotësohet në këtë dokument. Tjetër, çka po dua të them është se ne gjatë monitorimit të Ligjit për miniera dhe minerale, njëri nga rekomandimet për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ka qenë edhe sjellja

sa më parë e këtij dokumenti në Kuvend. Ne kemi dhënë një afat gjashtëmuor, por ky dokument është sjellë edhe më herët. Ne kemi marrë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik edhe ato vërejtje të ashtuquajtura teknike, që duhet t'i rregullojnë datat dhe të harmonizohen me kohën në të cilën jemi. Ne sigurisht që do t'i marrim si komision, do t'i nxjerrim edhe rekomandimet si komision për seancë plenare, duke u bazuar në dëgjimin publik, duke u bazuar edhe sigurisht edhe nga debati i sotëm.

Myzejene Selmani - Ne kemi dokumentin përpara, si tha edhe kolegja ime, e cila ka kaluar në dy mbledhjet e mëparshme të komisionit, mirëpo ka qenë edhe në mandatin e kaluar dhe i është kthyer Qeverisë. Ministri ndoshta e ka pasur një dokument bazë nga legjislacioni i kaluar, apo më mirë të themi nga ministri i kaluar i energjisë. Mirëpo, në këtë strategjinë, unë them shumë sinqerisht pa kurrfarë kompleksi, ndoshta jo në të keqe por në të mirë të strategjisë, unë llogaris vetëm prej faqes 33, strategji e cila mund të jetë një vizion i qartë i Qeverisë çka don me ba. Se kjo pjesa përpara tregon sasinë e minierave që e ka Kosova. Ajo është çështje që më shumë është në efektin e planit, që ministri e ka në Departamentin e minierave, si qëndron çështja me mineralet në Kosovë, ndërsa kjo çështja tjetër, korniza ligjore, çështja e analizës e aftësisë konkurruese, *sëot analiza*, e cila duhet të jetë me një strategji. Ndërsa, çështja e vizionit dhe misioni i strategjisë është mbetur, ndoshta renditja nuk është aty ku duhet me qenë, mirëpo me disa rekomandime, ndoshta që do të japim edhe në seancë plenare, kjo strategji do të merr formën e duhur. Edhe një herë po potencoj për çështje që ky dokument duhet të miratohet në Kuvend të Kosovës, të merr një formë, se unë s'jam kah them që është dokument i keq, do të merr një formë, se ministri është me sa më duket edhe ligjërues brenda fakultetit, e din se si duhet të hartohet një strategji, një dokument strategjik. S'po dua të hy në detaje tjera, mirëpo kish me qenë e një forme shumë të mirë që të qitet misioni, vizioni, *swot analiza*, strategjia në aspektin afatshkurtër, afatmesëm, afatgjatë dhe të kemi një dokument, i cili do të mbetet, ndoshta jo për 25 vite, se ndërron situata, se ekonomia e lirë e tregut e ndërron çdo moment situatën për sektorin e minierave dhe të kemi një dokument të mirë.

Visar Ymeri - Së pari unë mendoj që strategjia e vërtetë duhet të diskutohet në Kuvend. Mendoj që Kuvendi do të duhej të jepte dritën e gjelbër strategjisë, që është shumë e rëndësishme, është një institut tejet i rëndësishëm për Kosovën. Nuk mjafton me e dënuar, ta zëmë Qeverinë për gabimet e saj pas katër vitesh, nëse bën gabime për shkak se mund të bëhen gabime, të cilat s'mund t'i kthejmë prapa më. Edhe katër vite janë shumë, prandaj Kuvendi duhet të ketë një rol aktiv në këtë strategji, por edhe në strategjitë tjera të cilat kanë të bëjnë me sektorë të rëndësishëm ekonomik për shtetin. E të gjithë po pajtohemi këtu që sektori minerar është më i rëndësishmi për Kosovën, për zhvillimin ekonomik të Kosovës, por edhe përgjithësisht për qëndrueshmërinë politike të Kosovës, dhe në këtë sektor, natyrisht që po ashtu, të gjithë po pajtohemi që janë dy ndërmarrje, të cilat janë shumë të rëndësishme. Pra, në njërin anë KEK-u, prodhimi i energjisë prej linjtit, meqenëse Kosova i ka gjithë ato rezerva të linjtit dhe në anën tjetër "Trepça" me resurset e veta metalurgjike të minierave, po ashtu edhe të përpunimit të metaleve. Pyetja kishte me qenë, a po planifikon Qeveria me i privatizuar këto resurse dhe partneriteti publiko-privat, që e përmendët, do të shkojë në anën e privatit apo në anën e publikut? Pra, kush do ta ketë përqindjen kryesore? Me sa kemi pa dhe me sa kemi dëgjuar nga mediat, për projektin e parë të rëndësishëm publiko-privat, që e ka Qeveria e Kosovës, pra, për Kosovën e Re, pjesa më e madhe e aksioneve vendimmarrëse, do t'i takojë natyrisht, kapitalit privat. Dhe, nëse kështu vazhdohet edhe me "Trepçën", atëherë, a vërtetë mendoni që kjo ka me qenë mënyra më e mirë për me e zhvilluar Kosovën, duke e pasur parasysh që në këso lloj marrëveshesh Kosova ka me përfituar shumë pak. Në anën tjetër desha të pyes, po ashtu për "Trepçën", në strategjinë të cilën e keni paraqitur këtu, e cila dorën në zemër, unë po e kuptoj pse është këtu 2010-ta, se 90% e tekstit është nga strategjia e kaluar. Shumë pak ka shtesa e edhe më pak ka heqje nga ajo strategji. Domethënë, nëse i krahason këto dy tekste, pjesa më e madhe mbetet e njëjtë. A është marrë parasysh këtu plani i menaxhmentit të "Trepçës", i cili është

aprovuar në vitin 2007, për rikonstruktimin e “Trepçës”? E dimë që ai plan ka qenë një plan, i cili nga ekspertët është cilësuar si plan shumë i mirë, i cili do ta vendoste “Trepçën” në nivelin e ndërmarrjeve më funksionale dhe profitabile. Pra, sipas atij plani “Trepça” kërkon diku 176.000.000 euro investime, të cilat do të jenë diku 150.000.000 euro do të jenë investime drejtpërdrejtë në miniera dhe në zhvillimin e kryesisht teknikës dhe teknologjisë në “Trepçë”, ndërkohë që diku 25.000.000 euro janë investime në çështje sociale, pra në punëtorët minatorët e “Trepçës”, e kështu me radhë. Dhe, në këtë drejtim natyrisht, që “Trepça” do të duhej të udhëhiqej nga një menaxhment profesional, i cili ka përvojë dhe i cili ka vullnet që ta shndërrojë “Trepçën” në ndërmarrje të suksesshme. Dhe, pyetja e fundit tash për tash, lidhet me tabelën 9.1, në strategji të cilën e keni dorëzuar, ku në njërën prej kolonave janë edhe rentat minerare, pra, në çka janë bazuar këto renta minerare dhe sa janë reale këto renta minerare. Me sa është raportuar tantimat apo renta minerare për thëngjillin, nga 0.26 centë në tonë do të ngritën në 0.75 centë për ton, kur të ndërtohet Kosova e Re. Pra, përderisa këto në disa miniera të linjtit, për shembull, në Mirash, Sitnicë, e keni 84 euro, tash a është kjo euro, se këtë nuk po e kuptoj në çfarë shume është kjo dhe në çka është bazuar kjo domethënë a është për ton a me çfarë sasive paguhet kjo rentë.

Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik – MZHE – tha se Parlamenti të jep edhe sugjerime, të cilat do ta përmirësojnë cilësinë e strategjisë. Pse dokumenti mbanë 2010-shin, mund them që mund të jetë deri 95% e dokumentit që është shkruar më parë, sepse këto janë ato minerale, një dokument me një orientim politik dhe me një orientim zhvillimor nga ai paraprak. Prandaj, do të ishte jokorrekte me thënë që tash çka u bë përpara u bë keq edhe hajde tash na po e ndryshojmë. Po ua them shumë drejtpërdrejtë, sepse nuk mund të thuhet tash çka u bë 2010-ën hajde ta ndryshojmë krejt. Dokumenti nga Kuvendi, të nderuar deputetë është kthyer pa shpjegim. Ne nuk e dimë edhe sot e kësaj dite pse ka ndodhur kthimi. Ne kemi marrë transkriptin, të mbledhjes së Kuvendit edhe e kemi analizuar, por, rendi dhe rregulli e do që komisioni është dashtë vetë me ardhë. Dokumenti si i tillë, bazohet në orientim afatgjatë për rritje të shfrytëzimit më të mirë të ekonomisë të kapaciteteve minerale të Kosovës. Ky dokument është bërë dokument nga, kryesisht, nga njerëz që merren profesionalisht me atë fushë, nga KPMM-ja dhe nga përfaqësues të “Trepçës”. Prandaj, ky dokument jo që është parë nga menaxhmenti i “Trepçës”, por, është aprovuar nga menaxhmenti i “Trepçës”, sikurse edhe nga KPMM-ja. Dhe, për aspektet profesionale ju kam thënë edhe këtyre, të dy palëve, që do t’ju mbaj juve përgjegjës. Sepse, nuk është dokumenti, do të thotë, ai i cili, ne si Qeveri, përveç një departamenti, pa u përfshi, sepse ky nuk lidhet me një ministri apo me ministrinë tjetër, por lidhet me shtetin në përgjithësi. E thash në fillim se strukturën qysh e kanë mendua kjo grup ka qenë, se pjesa e parë është përshkrim i gjendjes aktuale, i rezervave, për të përfundu me, për të shkruar do të thotë, në drejtim të përfundimit me legjislacion aktual, i cili është në fuqi dhe pastaj me të hy për të ardhmen, që paraqitet vizioni, misioni dhe gjëra tjera. Këtu nuk ka standard, qysh me thënë, të dokumenteve të tilla strategjike. Dokumenti nuk është dokument, i cili vendoset tash dhe betonohet. Në dokument parashihet rishikim çdo tre vite, sepse mund të ndryshon situata. Ne sot i kemi rentat minerare për linjit 26 centë, por ne jemi duke punuar me Ministrinë e Financave, me KPMM-në, me të gjithë që këto renta minerare të rrisim në nivele, jo në 75, ne jemi duke menduar shumë më shumë me i rritë. Dhe ato t’i ndajmë në dy shtylla. Një, shtylla për shfrytëzim publik dhe shtylla për kapital privat. Dhe, këtu jemi kah hyjmë në kontekstin e asaj që jemi duke diskutuar me Fondin Monetar dhe me të gjithë, me Fondin Monetar Ndërkombëtar, sepse ne po dëshirojmë me i valorizua resurset tona natyrore. Ju keni kërkuar në Parlament, kur është, kur kemi diskutuar edhe për rishikimin dhe amendamentimin e Ligjit për Miniera, me pas edhe ligj për mbetjet minerare, sepse prapë aty është tendenca për valorizim të atyre mbetjeve. Strategjia si e tillë, është dokument, kur të përfundohet është dokument i Kuvendit. Nuk është dokument i ministrisë, por është dokument i Kuvendit sepse Kuvendi me aprovimin e tij ia jep vulën, do të thotë, shtetërore, institucionale. Është paraparë, por mendoj që është orientim i ekonomisë së tregut, që të parashihet edhe futja e kapitalit privat. Unë nuk mund të prejudikoj

aspak se çfarë relacionesh do të ketë. Ato janë marrëdhënie kontraktuale, për të cilat ne nuk duhet, unë së paku nuk do t'i jap vetes me thënë që tash do të jetë ky raport apo ai raport. Ato janë raporte, të cilat definojnë, sepse ne e kemi partneritetin e parë publiko-privat në aeroport të Prishtinës, i cili ka paraparë 49% të hyrave nga qarkullimi dhe pas 20 vjetësh me u kthye prapë në pronë. Mundësia është të hapet si orientim. Ndërsa, sa i përket funksionimit dhe "Trepçës" në përgjithësi dhe investimeve, të cilat janë bërë, ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve me interes të veçantë dhe Ligji për AKP-në, të cilin e kemi kaluar në Kuvend, e definojnë qartë. Sepse, ka pas moskuptim edhe atëherë në ligj në përgjithësi. Dhe, ajo ka qenë do të thotë, kush është komiteti kreditor. Dhe, "Trepça" tani është duke diskutuar modalitetin e funksionimit të saj. Ne e kemi kryer si Qeveri, në momentin kur e kemi përgatitur legjislacionin, në momentin kur e kemi përgatitur bazën për likuidim, për akreditim apo le të themi certifikim të atyre kompanive pretenduese, që kanë në "Trepçën" pjesë dhe komiteti i likuidatorëve do të vendosë pastaj për fazat tjera dhe ne me krejt ato angazhimet financiare, që janë bërë nga buxheti publik do ta paraqesim Qeverinë si kreditorin e parë, numër një dhe do të jetë roli kryesor i vendimmarrjes në këtë proces. Ne jemi në proces të ridefinimit të rentave, nuk do të jap numër tash, sepse neve na është rekomanduar, do të thotë, të shkohet në nivele relativisht të larta të minierave, por duhet të kujdesemi që të mos kemi edhe taksime të dyfishta, sepse ka ide që të krijohet një fond ambientalist, në njërën anë dhe ka ide që të krijohet renta minerare, në njërën anë dhe ne duhet të kujdesemi që të mos krijojmë tatime të dyfishta, të cilat do ta rëndojnë sektorin në përgjithësi, por ta bëjmë sektor, i cili do të jetë atraktiv. E kam parë që këtu edhe INKOS-i ka qenë pjesë e debatit publik atë ditë. Më duhet të ju them që ne ia kemi dhënë mundësinë INKOS-it si Qeveri, që të inkorporohet në kuadër të Institutit Gjeologjik, nëse dëshirojnë të bëhen pjesë e IGJK-së, në mënyrë që qasja e vetme strategjike e kërkimeve hulumtuese shkencore të bëhen përmes këtyre institucioneve. Instituti, edhe pse me ligj, e kam thënë edhe më herët, është quajtur gabimisht, po e kemi trashëguar një proces të tillë, sepse thirret Agjencioni, Instituti Gjeologjik i Kosovës. Ligji i cili ka kaluar dhe që mua më obligon me e themelue, nuk mund të jetë edhe agjencion edhe Institut, sepse agjencioni merret me çështje operative. Instituti merret me hulumtime shkencore.

Ahmet Tmava (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale –KPPM) - Ne si Institucion me të drejtë profesionale kemi dhënë kontribut dhe është një nga punimet më rëndësishme, ndoshta, që reflekton edhe në aspektin zhvillimor, siç u cek edhe këtu. Pjesa e përgjithshme, edhe atë ditë u tha dhe tash po e përsëris se, janë marrë të dhëna të pasurimit të resurseve, është bërë një përmbledhje e të dhënave, të cilat ekzistojnë. Dhe, besueshmëria e tyre ndryshon në kohë dhe hapësirë, ndryshon në kohë duke u avancuar edhe niveli i punimeve gjeologo-zbuluese, që na për këtë edhe japim licenca hulumtimi, por mbi të gjitha dy projekte shumë madhore, që janë bërë në Kosovë, hulumtime gjeofizike dhe hulumtime gjeokimike, që janë krejt në finale, e rrisin shkallën e studjueshmërisë dhe këta parametra mund të ndryshojnë. Kompleksiteti i paraqitjes së resurseve minerale është shumë më kompleks se sa këtu që paraqitet, sepse elaborate të tëra prezantojnë veç një lloj të resursit në Kosovë. Një temë që u ngrit këtu, po duhet, se edhe atë ditë u ngrit këtu, do të thotë, studimi i fizibilitetit, ndryshon në kohë dhe hapësirë. Ndryshon sepse një studim i fizibilitetit, që është bërë para dy vjetësh, ata parametra sot nuk vlejnë, bile-bile unë mendoj që nuk duhet ato të futen hiç si vlera, nëse veç nuk përkojnë me realitetin. Në aspektin e përcaktimit si vlerë valutë. Por, ajo që është me rëndësi të diskutohet, është renta. Me ligj duhet me u aprovua në Parlament edhe ky është një argument i asaj se specifikimet që duhet të pasojnë do të bien në Parlament. Renta minerare duhet të aprovohet në Parlament. Pse po e potencoj këtë? Po e potencoj këtë se rentat minerare për mua nuk është veç një vlerë që duhet të paguhet për resursin, por është një vizion i strategjisë, është një lloj rregullatori. Pse rregullator? Rregullator, sepse nëse ta zëmë sot KEK-u e paguan 3 cent një ton, decidoj po flas në bazë të vlerave të cilat janë në regjion, 5% e vlerës së valorizime të resursit duhet të shkojnë si vlerë e përcaktimit të rentës minerare dhe në bazë të këtij parametri, në bazë të kalkulimeve që kemi bërë renta minerare për një ton qymyr duhet të jetë 3 euro, nëse do dikush me hy 1 000 000 000 ton qymyr nga 15 000 000 000 Kosova ka me i paguar 3 000 000

000 veç pse e shfrytëzon resursin pa e marr taksat tjera. Krejt në fund dua të them në këtë formë do të krijohet për çdo lloj resursi në mënyrë të specifikuar, të metalizuar, por në vija të trasha unë mendoj se strategjia e jep esencën e zhvillimit.

Visar Ymeri – tha se nuk ka kurrfarë lidhje mes asaj që po e quajnë këtu “ekonomi tregut” edhe “ndërmarrje shtetërore”. Pra, në sektorët strategjik për vendin secili vend edhe pse ka ekonomi tregut vendos mos me i privatizuar. Kjo është e drejtë legjitime e secilit vend, pra kontrolli sovran përmbi resurset është edhe duhet të mbetet sovran. Si të privatizohen ato nuk ka më kontroll sovran, pra duhet ta kemi të qartë të gjithë. Edhe ekonomia e tregut nuk e përcakton privatizimin e çdo shteti, ekziston një teori ekonomike që thotë duhet me u privatizuar gjithçka, por ekzistojnë edhe nja 10 teori tjera që thonë s’dua me u privatizuar kurrgjë edhe ekzistojnë edhe nja 20 tjera që thonë duhet me u privatizuar gjithçka e diçka mos me u privatizuar. Pra, na këtu po flasim për një teori ekonomike e cila dorën në zemër kjo është kah dështon, privatizimi edhe te rregullimi i gjithçkaje është kah dështon edhe shtetet po heqin dorë prej asaj. E dyta unë mendoj që edhe për sa i përket strategjisë edhe këtij, domethënë përcaktimet ose orientimet kah kapitali privat edhe raportit mes partneritetit publiko-privat për të cilin foli edhe ministri, nëse shteti mu më thotë që na s’mundemi me përcaktuar se çfarë përqindje do të na mbajë në tërësi, atëherë për mu ai nuk është shtet. Pra, ti i cili je ai që po i shet aksionet, ti i pari dhe i vetmi që duhesh me përcaktuar sa aksione do me i shitë. Kjo është edhe me pronarin privat, por është veçanërisht, pra ti mundesh edhe nëse vendosë me i privatizuar një pjesë me thënë do t’i shesim 49% të aksioneve, 15% se preki. Edhe këtë ka drejtë shteti, e atyre të 49% pastaj le të ka liberalizim, le të blenë kushdo, mirëpo jo blerësi me ta caktuar ty politikën strategjike se për sa kohë që blerësi ta përcakton politikën strategjike, atëherë në fakt ai bohet shefi e jo ti. Pra, heqja dorë nga sektori ekonomik dhe sektori i mineraleve në përgjithësi do t’i bëjë të tjerët e neve do të na bëjë, pastaj në vendin tonë rroktar apo siç po thuhet nganjëherë “refugjatë”. Për strategji, mendoj që në këtë strategji mungojnë përgjithësisht qëndrimet lidhur me orientimet strategjike, pra për tu konkretizuar ajo p.sh. cilat do të jenë përfitimet e Kosovës nga aktiviteti minier sipas viteve apo në kuadër të ndonjë dinamike globale? Nuk ka një plan dinamik se si do të përfitojë Kosova, domethënë duke kaluar vitet, duke u zhvilluar sektorët dhe çfarë përfitimesh do të ketë Kosova si shtet. Pse është strategjia e rëndësishme, mendoj unë dhe aty pajtona me ministrin që jo domosdoshmërisht atë çka ka bërë të kaluarën duhet të ndryshojë veç se ka ndryshuar Qeveria, por të gjitha gjërat e mira që kanë ndodhur në të kaluarën duhet të vazhdojnë të ndodhin, mirëpo strategjia e suksesshme është një strategji e cila i mbijeton populli. Nuk mundet të kemi një strategji e cila si mbijeton popullit, e cila duhet të ndryshohet për çdo vjet, atëherë nuk është strategji atëherë është vetëm një supozim i cili do të ndryshojë vitin e ardhshëm. Nëse ndihmon kapitali privat le të ndihmon, por nëse s’të ndihmon ne nuk mund të heqim dorë nga resurset tona veç pse s’po ka investitorë. Unë besoj që ka me pas investitorë këtu por, mendoj që investitori në këtë lëmi do të jenë shumë të dëmshëm. Do të jenë të dëmshëm se për shkak se ta dini dhe ta keni parasysh edhe një gjë, ka praktika shumë të këqija botërore, veçanërisht të dhënat që i kanë pas resurset nëntokësore natyrale të cilat janë eksploatuar nga të tjerët pa kurrfarë përfitimi për vendin. Shumë pak ka raste të suksesshme në botë, ama shumë ka raste të pasuksesshme edhe shkatërruese për vendin. Kjo kryesisht varët edhe me nivelin edhe fuqinë që institucionet vendore e kanë. Pra, është bërë një faktorë tash kohët e fundit, një lloj variacioni në mes resurseve edhe dobësisë së institucioneve dhe ata që kanë pasur shumë resurse zakonisht i kanë institucionet e dobëta. Pse i kanë institucionet e dobëta, për shkak, pikërisht edhe për shkak të privatizimit të resurseve. Mirëpo me vendim të Kuvendit në projektin e Kosovës së Re do të bashkëngjitet edhe Kosova B, po qe se i bashkëngjitet Kosova B, atëherë cila do të jetë ajo kompani publike e cila do ta shfrytëzojë thëngjillin tonë për 26 cent. Meqenëse nuk ka ma termoelektrana që prodhojnë energji, që të dyja janë sektori privatizohet atëherë nuk kemi më publike, cila do të jetë a kemi ndërmend me votuar termoelektranat apo vetëm po flasim këtu sa për sy e faqe. Këto janë pyetjet që unë mendoj që janë shumë të rëndësishme për shkak se këtu

po flitet për interesat e Kosovës e ky është interes i cili është përmbi të gjithë neve si njerëz, por edhe të gjithë neve si përfaqësues të koncepteve të ndryshme publike.

Myzejene Selmani - më saktësisht te çështja e rentave minerare po të them shumë singlerisht nuk më kujtohet se a do të jetë kompetencë e Kuvendit a jo, mirëpo esenca është që rentat minerare caktohen edhe nga ju si KPMM edhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe njëkohësisht nga dikasteri i Ministrisë për Financa e cila derdhet direkt në buxhetin e Kosovës. Çështjen e potencoi ministri Beqaj mjaftë mirë, një shtyllë e rentave minerare për arsye edhe KPMM-ja është pjesë edhe e Komitetit drejtues të termocentralit Kosova e Re, dhe çdo licencës që i jepet në sektorin e minierave, shtylla publike dhe shtylla private. Në rast se do të mbetet që ju të caktoni për KEK-un apo për “Trepçën” në rastin adekuat, do të caktoni një rentë kisha kërkuar që te KEK-u ju e thatë do të shkojë deri në 3 euro. Duhet të kemi kujdes për arsye të gjendjes ekonomike, sociale çfarë gjenden qytetarët e Kosovës, duhet të kemi kujdes se kjo reflekton direkt në çmimin e energjisë elektrike. Ndërsa për operatorin e ri i cili do të vjen me ndërtuar termocentralin Kosova e Re nuk e di se kush do të vjen, sa ajo do të bëhet përzgjedhje në mënyrë transparente, në rast se donë rrymë për eksport, atëherë jo 3 por të kisha thënë plus 6. Atëherë, ai duhet t’i paguajë shtetit të Kosovës, ndërsa për shtyllën publike të keni kujdes se pavarësisht se kush është në Qeveri. Kisha kërkuar se ju jeni edhe ata përfaqësues që merrni pjesë edhe te Ministria e Zhvillimit Ekonomik edhe te Ministria e Financave, edhe te Komiteti për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re që këtu të keni kujdes te shtylla publike, ndërsa shtyllën private unë ju thash plus 6 sepse Ligji i përcakton, po kuotën e çmimit e përcaktojmë ne.

Lutfi Zharku – tha se qasja e parë është qasja e ndërmarrjeve që strategjia bisedon shumë për Trepçën, për KEK-un për tjerat, edhe qasja e dytë është qasja që thjesht i mungon strategjisë së zhvillimit të sektorit minerar. Domethënë kisha dëshirua thjeshtë nga ana profesionale që strategjia me u marr me mineralet, por jo me ndërmarrjet. Kur të flasim në anën tjetër për rentat minerare mendoj se kemi pak mos me thënë keqkuptime ose keqinterpretime. E para cili është qëllimi i rentës, duhet me pas strategji. A është qëllimi i rentës me mbush buxhetin, a është qëllimi i rentës me krijuar nxitje për zhvillimin e bizneseve? Krejt çka po bisedojmë ne është ajo që renta në situatën tonë ekonomike apo kushtet tona ekonomike duhet ta ketë qëllimin edhe kur të përcaktohet me nxitë zhvillimin e bizneseve të reja, me nxitë zhvillimin e atij sektori minerar. Renta apo lartësia e rentës nuk guxon të bëhet element që dikush mos me pas interesim për me investuar. Në anën tjetër, po bisedohet për rent, të themi për sektorin privat apo sektorin publik. Personalisht për mua nëse e ndajmë sektorin privat dhe sektorin publik te renta është një diskriminim të them i hatashëm ndaj sektorit privat. Ne nuk mundemi me konsideruar zhvillimin e sektorit privat si diçka e egër, si diçka që është kundër shtetit, si diçka që nuk na qon përpara. Trajtimi i ndryshëm në rentë për sektorin privat dhe sektorin publik për mua është i pa qartë. Unë kam një bindje personale që “Trepça” me pas pasur një qasje të privatizimit që 12 vjet nuk ishte kështu, se me kanë e privatizuar ose me pas një pjesëmarrje të kapitalit privat në “Trepçë” ose ish zhvilluar ose ish mbyll krejt.

Arbnor Kastrati (MZHE) – tha se kam veç me dhënë një koment në lidhje me investime që faqe 45 të strategjisë pika 4.5. flet në lidhje me nevojat për investime. Unë nuk kisha dasht tash me ju humb kohë, me ju lexuar çka thotë pika, por ju kisha lutur që në faqe 45 pika 4.5. flet në lidhje me këtë. Edhe normal, parashihet rishikimi çdo tri vjet si dhe programi i zbatimit njëjtë për çdo 3 vjet.

Kryetari – tha se strategjia bazohet në tregun e plotë të lirë, po pak a shumë ajo çka është më e rëndësishme me këtë strategji është që ka qenë e munguar, ne duhet me i dhënë shansin me institucioneve tona me punuar në kornizat e një strategjie që jep mundësi për zhvillimin e këtij sektori dhe po ashtu ajo që u tha këtu është një dokument i cili me siguri që do të plotësohet në kohën që vjen, me vetë faktin që edhe mbasi është kthyer kjo strategji e u tha këtu nuk dihen

ende shkaqet e vërteta edhe në strategji figuron edhe data e kohës kur është punuar, domethënë është punuar në të njëjtin dokument dhe konsiderohet që i njëjti dokument pavarësisht se miratohet apo s'miratohet në Kuvend do të jetë bazë për ndryshim edhe më tutje. Unë ju kisha kërkuar që ne si komision ta kalojmë, ta votojmë. T'i japim mundësinë Kuvendit që Kuvendi le ta ketë edhe një debat, edhe një mundësi për aprovim.

Visar Ymeri – tha se si komision nuk e kemi debatuar këtë deri në fund dhe i kemi dëgjuar tjerët më shumë. Vetë na se kemi debatuar, tash ju nëse mendoni që nuk është rëndësishme me u debatuar ky dokument atëherë në rregull, unë mendoj që është për tu debatuar ende ne Komision.

Myzejene Selmani – tha se qysh kish me qenë ndryshe debati, përveç kësaj kjo është dëgjim publik, çka kish me dal më tepër në qoftë se kishim vendosur me debatuar si komision? Krejt kush çka ka dashur i kemi thënë.

Visar Ymeri – tha se nëse kurrkush nuk do me fol atëherë në rregull. Ne po e lëmë një pikë të rendit të ditës, në njërën prej komponentëve po e debatojmë dhe po e votojmë. Por, për sot nuk ka qenë që të mirret vendimi të paktën sa kam kuptuar prej agjendës.

Kryetari – tha se konsideroj që sot e kishim mundësinë edhe e kemi ende. Nuk është problemi me fol për këto punë, na i japim hapësirë me dërguar edhe me vazhduar me agjendën tjetër. Ne bëjmë debate të hapur, e patëm një kohë ministrin, por jam që debatin e hapur e bëjmë në Parlament edhe mundem unë me u shpreh më shumë, mundeni edhe ju. E kisha qit në votim e pastaj, po me ndryshimet me propozimet që kanë ardhur nga ministria edhe disa që janë kryesisht teknike.

Visar Ymeri – tha se me Rregullore të Punës së Kuvendit rendi i ditës duhet me u dërguar 4 ditë para mbledhjes, ky rend dite neve na ka ardhur pardje për dje edhe u shty mbledhja për sot. Pra, kjo së pari nuk është në rregull, se është shty mbledhja për të njëjtën ditë edhe e dyta është që a janë dërguar edhe disa ndryshime teknike nga Qeveria, të cilat nuk i kemi as sot. E treta është që strategji kemi qasi gabime banale sa që në fund ma e ki 2010-2015 po doni me ia dërguar Kuvendit, është absolutisht e papërgatitur për me ia dërguar Kuvendit.

Kryetari - së pari s'po dua me qenë procedural po dua me qenë korrekt. Ky takim është thirr me datën 9.12.2011 zakonisht atë ditë që i nënshkruaj unë ftesat për mbledhje ju vijnë juve, zakonish. E dyta, atë ditë kur e kemi thirr dëgjimin ju kam thënë edhe juve sot po i dëgjomë këta, në takimin tjetër kur e shqyrtojmë e thirrmin ministrin, kështu ka qenë. Në fund kërkoi që të shkon në votim Strategjia minerare më vërejtjet apo ndryshim plotësimet nga Qeveria.

Pas debatit Komisioni më pesë (5) vota Për, dy (2) Kundër dhe Një (1) Abstenim, nxori këtë

Përfundim

Miratohet Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025

Dhe Kuvendit i parashtrohet këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025, më plotësimet dhe ndryshimet si në vijim:

- **Në faqen 26 të shtohet teksti:** Me vendimin nr. 02/46 të datës 02.11.2011 të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës për ndalimin e shfrytëzimit të materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Vendimi nënkupton ndalimin e përkohshëm,

deri në 3 vjet, të të gjitha aktiviteteve shfrytëzuese në lumenj dhe përrreth tyre. Ky vendim ka qenë i domosdoshëm për të ndaluar përfundimisht degradimin e mëtejshëm të lumenjve.

- **Në faqen 33 të shtohet teksti:** 1. Ligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre Nr. 04/-L 035; 2. Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-033; 3. Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034;
- **Në faqen 34 dhe 35 (me fusnotat e propozuara) të shtohet teksti:** Sipas ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 50 të Ligjit për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre, Ligji Nr. 04/L-035 që ka hyrë në fuqi më 26.10.2011, lidhur me Vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. SCR-05-001, të datës 09.03.2006, si dhe vendimit pasues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme Kosovës Nr. SCR-05-001-R008, R009 dhe R011, të datës 19.05.2011, AKP shpall moratorium për Ndërmarrjet Thelbësore të Trepçës dhe Ndërmarrjet Tjera të Trepçës që kanë hyrë në fuqi nga data 8 Nëntor 2011. Vendimi për Moratoriumin mbi Kompleksin Trepça nënkupton që prej datës 8 Nëntor 2011 të gjitha veprimet, procedurat dhe veprimet e çfarëdo lloji që kanë për qëllim përcaktimin e vlefshmërisë, zbatimin apo përmbushjen e kërkesave apo interesave lidhur me Trepçën, apo Pasurisë së sajë, pezullohen dhe mund të vazhdojnë vetëm me lejen e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet Lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
- **Në faqen 35 të fshihet teksti:** Aktualisht, Kompleksi Trepça është nën vendimin e Moratoriumit të dhënë nga dhoma e posaçme e gjykatës supreme të Kosovës, sipas kërkesës së Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, që nga viti 2006. Vendimi për Moratoriumin mbi Kompleksin Trepça nënkupton që Kompleksi i nënshtrohet procedurës së riorganizimit, në përputhje me procedurat e përcaktuara me rregulloren e UNMIK-ut 2005/48 mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve nën autoritetin administrativ të AKM-se (tani AKP-se), qëllimi i të cilit proces është ristrukturimi profesional i ndërmarrjes dhe operatorëve të saj të biznesit, me qëllim të kthimit të qëndrueshmërisë së biznesit për shlyerje të detyrimeve të ndërmarrjes ndaj kreditorëve meqenëse veprimet procedurale për qëllime të përmbylljes së procedurës së riorganizimit nuk janë ndërmarrë në afatet e përcaktuara ligjore, çështja e procedimit ka mbetur pezull.
- Në tërë tekstin e Strategjisë të përmirësohet teknikisht periudha kohore; duhet të jetë “2012-2025”.

4. Të ndryshme

Kryetari – I njoftoi deputetët lidhur me vizitën e Komisionit të realizuar në Turqi nga data 04-07.12.2011 dhe së është hartuar një Informate nga Njësia mbështetëse rreth vizitës së delegacionit të Komisionit. Edhe e falënderoi zotin Damka që ka qenë bashkë me Odën Tregtare Kosovaro-turke, tutje që e ka konkretizuar këtë aktivitet apo vizitë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit